

TELEKOM ALBANIA Sh.A.

OFERTA REFERENCE E INTERKONEKSIONIT (ORI)

Versioni 2.0

*(miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP nr.2176 date
29.10.2012)*

I- Permbledhje

- a. Në zbatim të Ligjit 9918, Rregullores se Aksesit dhe Interkoneksionit dhe Vendimit te Keshillit Drejtues te AKEP Nr. 2119, datë 4.07.2012, qe percakton TELEKOM ALBANIA si Sipermarres me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në tregun me shumice te terminimit, TELEKOM ALBANIA boton kete Ofertë Referencë të Interkoneksionit (ORI) të TELEKOM ALBANIA..
- b. ORI percakton kriteret dhe procedurat per rregullimin e marredhenieve te interkoneksionit, me perjashtim terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare, ndermjet TELEKOM ALBANIA si Ofrues i Interkoneksionit dhe Operatorit Perfitues ne lidhje me sherbimet dhe fasilitetet shoqeruese, te interkoneksionit qe lidhet midis TELEKOM ALBANIA dhe Operatorit Perfitues.
- c. ORI zbatohet per sipermarresit qe operojne ne Republiken e Shqiperise,te cilet jane te autorizuar sipas regjimit te autorizimit te AKEP dhe qe kane te drejte te interkonektohen, ne perputhje me Ligjin 9918, date 19.05.2008, “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise” (Ligji 9918), Rregulloren per Akses dhe Interkoneksion, Rregulloren per Autorizimin e Pergjithshem dhe cdo akt tjeter rregullator, qe ka lidhje me kete Oferte Reference, ne fuqi te miratuar nga AKEP.
- d. TELEKOM ALBANIA ofron sherbimet ne piken e interkoneksionit dhe lejon aksesin drejt ketyre sherbimeve dhe Operatori Perfitues, sipas Autorizimit leshuar nga AKEP, perdor sherbimet sipas percaktimeve ne kete ORI.
- e. Kjo ORI sherben si baze per Marreveshjen e Interkoneksionit midis TELEKOM ALBANIA dhe operatorit perfitues, marreveshje e cila do te perfshije edhe sherbimet e ofruara nga Operatori Perfitues ne perputhje me Rregulloren per Autorizimin e Pergjithshem, se bashku me tarifat perkatese.
- f. TELEKOM ALBANIA nuk mban pergjegjesi per permbajtjen e trafikut qe percillet nepermjet sherbimeve te tij te interkoneksionit.
- g. Marreveshja e Interkoneksionit nuk do te permbaje detyrime shtese per Operatorin Perfitues, detyrime te cilat nuk jane parashikuar ne kete ORI.
- h. TELEKOM ALBANIA si Ofrues i Interkoneksionit dhe Operatori Perfitues bien dakort qe te perdorin standartet teknike dhe te cilesise te pranuar nga AKEP dhe qe mbeshteten

ne rekomandimet e organizatave nderkombetare, ITU, ETSI.

- i. Kjo ORI hyn ne fuqi nga data e e miratimit te saj nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe vazhdon te mbetet ne fuqi deri ne shfuqizimin, ndryshimin apo zevendesimin e saj me ORI e re te miratuar nga ky institucion.
- j. TELEKOM ALBANIA mund t'a perditesoje kete ORI periodikisht, me qellim marrjen ne konsiderate ndonje ndryshimi te nevojshem qe mund t'i behet kesaj ne zbatim te ndryshimeve te mundshme te legjislacionit dhe akteve rregullatore te AKEP ose ndryshimeve te Sherbimeve te Interkoneksionit te ofruara nga TELEKOM ALBANIA sipas kesaj ORI. Keto ndryshime do te hyjne ne fuqi vetem pas miratimit nga AKEP. Keto ndryshime apo perditesime te ORI do te publikohen brenda 1 (nje) jave nga data e miratimit te AKEP.
- k. Tarifat e dhena ne kete ORI do te jene te disponueshme per te gjithë operatorët e interkonektuar ne baza jo-diskriminuese. Nese TELEKOM ALBANIA bie dakort me marrveshje me nje Operator per tarifa te reja, me te favorshme per operatorët se tarifate publikuara per çdo lloj sherbimi te perfshire ne kete ORI, ateher keto tarifa te reja do te jene te disponueshme per te gjithë operatorët e tjere te interkonektuar.
- l. TELEKOM ALBANIA mund te refuzoje dhenien e interkoneksionit/sherbimeve te percaktuara ne kete ORI per nje operator perfitues, vetem per shkaqe qe parashikohen shprehimisht ne Ligjin 9918, "Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit", dhe akte te tjera te nxjerra nga AKEP per kete qellim, duke perfshire dhe pamundshmerine teknike apo nevojat per te ruajtur integritetin e rrjetit.
- m. Në rast se TELEKOM ALBANIA refuzon dhenien e aksesit interkoneksionit atehere do t'i paraqese Operatorit Perfitues nje arsyetim gjithperfshires te shkaqeve te refuzimit dhe do te specifikojë afatin kohor te sakte, se kur kërkesa e Operatorit Perfitues do te permbushet. Nje kopje e arsyesimit do ti njoftohet AKEP.
- n. Kjo ORI mbulon terminimin per thirrjet hyrese kombetare drejt pajtimtareve/abonentet e rrjetit TELEKOM ALBANIA, te cilet jane ata abonentet qe:
 - Kane numer celular qe i perket serive numerike (068 xx xxxx) te alokuar nga AKEP TELEKOM ALBANIA, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje operatori tjeter, ose
 - Kane numer qe nuk i perket serive numerike te alokuar nga AKEP TELEKOM ALBANIA, por qe eshte portuar ne rrjetin e TELEKOM ALBANIA.

-
- o. Kjo ORI nuk mbulon terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare (qofte ato te terminuarata drejtperdrejte nga operatoret nderkomberatre qofte ato te tranzitura nga operatoret e licensuar ne Rep e shqiperise nepermjet tranzimitit te thirrjeve nderkombetare), drejt pajtimtareve/abonentet te rrjetit TELEKOM ALBANIA. Ky lloj sherbimi, do te trajtohet ne marreveshje te vecanta tregtare mes TELEKOM ALBANIA dhe partnereve te saj, rast pas rasti. TELEKOM ALBANIA ka detyrimin te pranoje per teminim vetem thirrje telefonike te destinuar per abonentet/pajtimtaret e TELEKOM ALBANIA te cituar me siper. Eshte pergjegjesia e Operatorit Perfitues te rrugezaje thirrjet drejt rrjetit te duhur per numrat e portuar, duke bere analizen e thirrjeve ne perputhje me rregullat e vendosura nga AKEP per portabilitetin e numrave dhe rrugezimin e thirrjeve drejt tyre.

PERMBAJTJA:

- QELLIMI DHE FUSHA E VEPRIMIT
- KUADRI LIGJOR
- PERKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET
- AFATI, HYRJA NE FUQI DHE VLEFSHMERIA
- INTERKONEKTIMI I RRJETEVE
- SHERBIMET E INTERKONEKSIONIT
- TARIFAT PER SHERBIMET E INTERKONEKSIONIT
- KERKESA PER SHERBIM INTERKONEKSIONI
- MATJET E VOLUMIT TE TRAFIKUT
- FATURIMI DHE MENYRA E PAGESES
- PROJEKTIMI DHE PLANIFIKIMI I RRJETIT
- MODIFIKIMI I RRJETIT DHE NDRYSHIMET NE ADMINISTRIMIN E TE DHENAVE
- SIGURIA E PERSONELIT DHE INSTALIMEVE / RUAJTJA E INTEGRITETIT TE RRJETIT
- NUMERACIONI
- IDENTIFIKIMI I NUMRIT THIRRES
- CILESIA E SHERBIMIT
- DHENIA E INFORMACIONIT
- PERDORIMI ABUZIV I MARREVESHJES SE INTERKONEKSIONIT
- ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE
- SHKELJA, PEZULLIMI DHE ZGJIDHJA E MARREVESHJES SE INTERKONEKSIONIT
- GARANCIA BANKARE

-
- RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT
 - TE DREJTAT E PASURISE INTELEKTUALE
 - RISHIKIMI I MI
 - FORCAT MADHORE
 - KUFIZIMI I PERGJEGJESISE
 - KALIMI I TE DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TEK TE TRETET
 - NJOFTIMET
 - TERESIA E MARREVESHJES
 - HEQJA DORE
 - VLEFSHMERIA
 - NDRYSHIMET
 - MARREDHENIA MES PALEVE
 - LIGJI I ZBATUESHEM DHE GJYKATA KOMPETENTE
 -

ANEKSET:

ANEKSI 1: PERKUFIZIMET

ANEKSI 2: SHERBIMET DHE TARIFAT E INTERKONEKSIONIT

ANEKSI 3: FATURIMI DHE PAGESA

ANEKSI 4: KARAKTERISTIKA TE PERGJITHSHME TE INTERKONEKSIONIT

ANEKSI 5: PROÇEDURA E PARASHIKIMIT TE KAPACITETIT TE INTERKONEKSIONIT

ANEKSI 6: PROÇEDURA E SHFRYTEZIMIT DHE MIREMBAJTJES SE
INTERKONEKSIONIT

ANEKSI 7: GARANCIA BANKARE

ANEKSI 8: PERSONAT E KONTAKTIT

ANEKSI 9: STANDARTET & REKOMANDIMET

1. QELLIMI DHE FUSHA E VEPRIMIT

- 1.1 Ne baze te Vendimit te Keshillit Drejtues te AKEP, Nr. 2119, datë 4.07.2012,(ketej e tutje Vendimi 2119) TELEKOM ALBANIA eshte sipermarres me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në tregun me shumice te terminimit per thirrjet hyrese kombetare dhe ka pergatitur kete Oferte Reference Interkoneksioni (ORI) në zbatim të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores mbi Aksesin dhe Interkoneksionin dhe detyrimeve te vendimit te AKEP per FNT te TELEKOM ALBANIA.
- 1.2 Qellimi i ORI eshte percaktimi i kriterëve dhe procedurave per rregullimin e marredhenieve te interkoneksionit ndermjet TELEKOM ALBANIA si Ofrues i Interkoneksionit dhe Operatorit Perfitues ne lidhje me sherbimet dhe fasilitetet shoqeruese, te interkoneksionit qe lidhet midis TELEKOM ALBANIA dhe Operatorit Perfitues, per te siguruar zbatimin e detyrimeve te TELEKOM ALBANIA ne perputhje me kerkesat dhe percaktimet e parashikuara ne Ligjin 9918, Rregullores per Aksesin dhe Interkoneksionin dhe Vendimin 2119.
- 1.3 Palet bien dakort te interkonektojne rrjetet e tyre ne perputhje me parimet e percaktuara ne Ligjin 9918, Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit dhe Vendimin 2119 dhe t’u sigurojne njera-tjetres sherbimet dhe facilitet sipas kushteve te paracaktuara ne kete ORI si dhe Marveshjen e Interkoneksioni (ketej e tutje “MI”)
- 1.4 TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues bien dakort qe te perdorin standartet teknike dhe te cilesise te mbeshtetura ne Rregulloret e AKEP dhe rekomandimet e organizatave nderkombetare si ITU apo ETSI.
- 1.5 TELEKOM ALBANIA mund te refuzoje dhenien e interkoneksionit/sherbimeve te percaktuara ne kete ORI per nje Operator Perfitues, vetem per shkaqe qe parashikohen shprehimisht ne Ligjin 9918, “Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit”, dhe akte te tjera te nxjerra nga AKEP per kete qellim, duke perfshire dhe pamundshmerine teknike apo nevojat per te ruajtur integritetin e rrjetit.
- 1.6 Në rast se TELEKOM ALBANIA refuzon dhenien e akses interkoneksionit atehere do t’i paraqese Operatorit Perfitues nje arsyetim gjithperfshires te shkaqeve te refuzimit dhe do te specifikoje afatin kohor te sakte, se kur kerkesa e Operatorit Perfitues do te permbushet. Nje kopje e arsyetimit do te depozitohet ne AKEP.

2. KUADRI LIGJOR

Dispozitat e kësaj ORI janë hartuar në përputhje me:

-
- 2.1. Ligjin Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ketej e tutje ”Ligji 9918”);
 - 2.2. Rregulloret e nxjerra nga AKEP ne zbatim te ketij ligji, akteve te tjera ligjore e nenligjore ne fuqi te cilat jane te detyrueshme per t’u zbatuar si dhe cdo Vendim tjetër i nxjerre nga AKEP me ndikim ne kete ORI
 - 2.3. Vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP, Nr. 2119, datë 4.07.2012, qe ka percaktuar TELEKOM ALBANIA sipërmarres me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) dhe masat rregulluese per kete status në tregun me shumice te terminimit te thirrjeve kombetare ne rrjetin TELEKOM ALBANIA dhe cdo akt tjetër te nxjerre nga AKEP qe synon ndryshimin, plotesimin apo shfuqizimin e tij.

3. PERKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET

- 3.1 Ne kete ORI, pervec rasteve kur konteksti e kerkon ndryshe, fjalet dhe shprehjet kane kuptimin e percaktuar ne Aneksin I (Perkufizimet) ose Aneksin II sherbimet.
- 3.2 Referencat qe i behet akteve ligjore dhe nenligjore i referohen ketij legjislacioni si dhe cdo amendimi te mundshem, apo akteve nenligjore te dala ne plotesim te ketij legjislacioni.
- 3.3 Termat e percaktuara ne aktet ligjore dhe nenligjore shqiptare, nese jane perdorur ne kete ORI do te kene te njejtin kuptim sipas atyre akteve.
- 3.4 Pa cenuar te drejtat e TELEKOM ALBANIA, ne rast te nje mosmarreveshje apo paqartësie mes termave te percaktuara ne ligjet dhe rregulloret e zbatueshme ne lidhje me kete ORI, do te zbatohet rendi i meposhtem i perparetise:
 - Ligji i Komunikimeve Elektronike ne Republikën e Shqiperise
 - Rregullorja per Aksesin dhe Interkoneksionin, si dhe
 - Cdo rregullore apo Vendim tjetër i nxjerre nga AKEP me ndikim ne kete ORI

4. AFATI, HYRJA NE FUQI DHE VLEFSHMERIA

Marreveshja e interkoneksionit e lidhur ne zbatim te kesaj ORI, fillon efektet nga data e percaktuar ne te dhe do te vazhdoje deri:

1. Ne kohen qe Operatorit Perfitues i mbaron afati i autorizimit, i revokohet autorizimi dhe Operatori nuk ka marre autorizim tjetër zevendesues per ofrimin e rrjetit dhe ose sherbimeve te komunikimeve elektronike per ofrimin e rrjetit ose sherbimeve te komunikimeve elektronike;

-
2. Ne kohen qe TELEKOM ALBANIA i mbaron afati i autorizimit, i revokohet autorizimi dhe TELEKOM ALBANIA nuk ka marre autorizim tjeter zevendesues per ofrimin e rrjetit dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike per ofrimin e rrjetit ose sherbimeve te komunikimeve elektronike;
 3. Zgjidhjen e marreveshjes sipas percaktimeve te kesaj RIO dhe MI e lidhur mes paleve, perfshire midis te tjerave, mos-ndryshimin, mos-plotesimin apo mos-rinovimin e Garancise Bankare sipas percaktimeve ne nenet 20 dhe 21;

5. INTERKONEKTIMI I RRJETEVE

- 5.1 Interkoneksioni per sherbimin e thirrjeve ndermjet rrjetit te TELEKOM ALBANIA dhe Operatorit Perfitues do te realizohet nepermjet nje ose disa pikave te interkoneksionit per te cilat do te bihet dakord mes paleve. Cdo pike interkoneksioni do te identifikojë nje lidhje mes nje nyje transmetimi te TELEKOM ALBANIA dhe nje nyje transmetimi te Operatorit Perfitues. Detajet perkatese te realizimit pershkruhen ne Aneksin IV (Karakteristikat e Pergjithshme te Interkoneksionit)
- 5.2 Pika reale e Interkoneksionit duhet te jete aty ku Rrjeti i TELEKOM ALBANIA lidhet me Rrjetin e Operatorit Perfitues dhe duhet te jete nje pike fizike ku lidhja te mund te shkeputet ne menyre qe te kryhen teste.
- 5.3 Aspektet teknike te lidhjes se interkoneksionit dhe ato funksionale jane te percaktuara ne Aneksin IV (Karakteristika te Pergjithshme te Interkoneksionit) te kesaj ORI
- 5.4 TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues do te jene pergjegjes per sigurimin e nje kapaciteti te mjaftueshem ne Piken e Interkoneksionit ne menyre qe te perballoje trafikun e parashikuar te rene dakord dhe qe permban Planifikimi i Rrjetit, sic pershkruhet ne Aneksin VI (Procedura e parashikimit te kapacitetit te interkoneksionit).

6. SHERBIMET E INTERKONEKSIONIT

- 6.1 Sherbimet e interkoneksionit qe palet ofrojne jane te percaktuara ne Aneksin II (Sherbimet dhe tarifat e Interkoneksionit) te Marreveshjes se Interkoneksionit
- 6.2 Palet bien dakord qe sherbimet e interkoneksionit te perfshira ne Aneksin II dhe qe jane objekt i rregullimit prej AKEP, te mos i ofrohen me kushte me te favorshme se ato te pershkruara ne kete ORI, rrjetit apo filialit te nje pale te trete te kontraktuar.
- 6.3 Afatet kohore per kryerjen e sherbimeve dhe standartet e cilesise se ketyre sherbimeve percaktohen ne Marreveshjen e Nivelit te Sherbimit (SLA), bashkengjitur Marreveshjes se Interkoneksionit

7. TARIFAT PER SHERBIMET E INTERKONEKSIONIT

- 7.1 Struktura e tarifimit dhe tarifat per çdo Sherbim Interkoneksioni pershkruhet ne Aneksin II (Sherbimet dhe Tarifat e Interkoneksionit) dhe Aneksin III (Faturimi dhe Pagesat) te kesaj ORI.
- 7.2 Tarifat e Sherbimeve te Interkoneksionit mund te ndryshohen ne perputhje me parashikimet e Ligjit nr 9918 dhe kuadrin rregullator perkates. Per tarifat e publikuara ne kete ORI dhe qe nuk jane objekt rregullimi nga AKEP, TELEKOM ALBANIA ka te drejte t'i ndryshoje duke bere publikimin ne ORI dhe njoftuar Operatorin Perfitues dhe AKEP te pakten 3 muaj para hyrjes ne fuqi te tarifes se re.
- 7.3 Koha e tarifueshme per çdo thirrje, perveçse kur specifikohet ndryshe, do te jete “Koha e Bisedes” ne perputhje me rekomandimin D.150 te ITU-T, i ndryshuar ne 1996, pra intervali kohor mes marrjes se nje sinjali pergjigje dhe marrjes se sinjalit perkates te leshimit, e matur nga Pala qe ofron te dhenat per tarifimin e interkoneksionit.
- 7.4 Asnje prej paleve nuk do aplikojte tarifim per percjelljen e thirrjes nese thirrja nuk eshte lidhur, kur ka:
1. ton “zile” pa pergjigje;
 2. ton “i zene”;
 3. ton “numer i padisponueshem”
 4. “Njoftim i rregjistruar informacion rrjeti”
- Per te shmangur cdo dyshim, sistemet voice mail (poste zanore) te klientit apo rrjetit nuk konsiderohen “Njoftim i rregjistruar informacion rrjeti”.

8. KERKESA PER SHERBIM INTERKONEKSIONI

- 8.1 Per lidhjen e marreveshjes se interkoneksionit Operatori Perfitues i ben nje kerkese TELEKOM ALBANIA sipas parashikimeve ne Ligjin 9918 dhe Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit. Nje kopje e kerkeses depozitohet ne AKEP.
- 8.2 TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues do te zbatojne parashikimet e Ligjit 9918 dhe Rregullores se Aksesit dhe Interkoneksionit ne lidhje me proceduren e negociatave, afatet dhe lidhjen e marreveshjes se interkoneksionit.
- 8.3 TELEKOM ALBANIA, nepermjet kesaj ORI, e cila gjendet e publikuar ne faqen zyrtare te TELEKOM ALBANIA, vendos ne dispozicion te Operatorit Perfitues, Informacionin e Pergjithshem te rrjetit qe operon si dhe informacionin lidhur me sherbimet e pershkruara ne kete ORI.
- 8.4 Operatori Perfitues, se bashku me kerkesen per interkoneksion, duhet t'i paraqese TELEKOM ALBANIA informacionin e nevojshem per te mundesuar vendosjen e zgjidhjes per anen teknike dhe ate komerciale se akses/interkoneksionit, si dhe dokumentacionin ligjor shoqerues te Operatorit Perfitues. Informacioni i lartpermendur eshte ne zbatim te

Rregullores “Per akses dhe interkoneksion” dhe detajohet ne Aneksin IV (Karakteristika te Pergjithshme te Interkoneksionit). Informacioni i nevojshem per te mundesuar vendosjen e zgjidhjes teknike te akses/interkoneksionit eshte i domosdoshem qe TELEKOM ALBANIA te projektoje nje zgjidhje optimale interkoneksioni.

8.5 Ne rast se teresia e dokumentacionit te mesiperm eshte jo e plote dhe i pamjaftueshem, TELEKOM ALBANIA do te lajmeroje Operatorin Perfitues brenda 10 (dhjete) diteve nga data e marrjes se dokumentacionit. Lajmerimi duhet te permbaje nje liste te detajuar pyetjesh dhe kerkesash mbi te dhenat qe nuk jane siguruar ne dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Perfitues.

8.6 TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues duhet te negociojne me mirekuptim me synimin per te arritur nje marreveshje mbi nje Planifikim Rrjeti te plote. Pasi palet te kene rene dakort per zgjidhjen teknike, kjo zgjidhje do te behet e ditur si Planifikim i Rrjetit dhe do te perfshihet ne Marreveshjen e propozuar te Interkoneksionit mes TELEKOM ALBANIA dhe Operatorit Perfitues.

9. MATJET E VOLUMIT TE TRAFIKUT

9.1 Pergjegjësia per matjet e volumit te trafikut do te jete e pales qe ben faturimin per ate sherbim te veçante Interkoneksioni.

9.2 Palet do te sigurohen qe te regjistrohet matja e volumit te trafikut ne detaje te mjaftueshme per te permbushur detyrimet siç jane dhene ne Aneksin II (Sherbimet dhe Tarifate e interkoneksionit) dhe Aneksin III (Faturime dhe Pagesa)

10. FATURIMI DHE MENYRA E PAGESES

10.1 TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues do te faturojne dhe rimbursojne njeritjetrin ne perputhje me tarifate dhe procedurat e dhena ne Aneksin II (Sherbimet dhe Tarifate e Interkoneksionit) dhe Aneksin III (Faturimi dhe Pagesat).

10.2 Tarifate do te jene te pagueshme nga njera pale tjetres, vetem nese keto sherbimet me tarifate perkatese ne fjale jane te parashikuara shprehimisht ne Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, si dhe ne rastin kur tarifa perkatese eshte vendosur me nje Vendim te AKEP.

10.3 Tarifate ne Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI nuk perfshijne TVSH. TVSH do te tarifohet ne faturate qe leshohen ne zbatim te kesaj ORI ne perputhje me Ligjin per TVSH ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

10.4 Faturate jane te pagueshme ne Leke dhe sipas menyres se percaktuar nga palet ne Marreveshjen e Interkoneksionit, ne perputhje me legjislacionin shqiptar per kete qellim. Ato do te datohen si per daten e leshimit te fatures (Daten e leshimit) dhe jane te

pagueshme ne ose perpara Dates perkatese per page, e cila eshte tridhjete (30) Dite Kalendarike nga Data e Leshimit.

- 10.5 Secila pale do t'i siguroje dhe dergoje pales tjetër faturat me te gjithë shumat per te cilat ai i detyrohet, te llogaritura ne perputhje me dispozitat e Aneksit III (Faturimi dhe Pagesat).

11. PROJEKTIMI DHE PLANIFIKIMI I RRJETIT

- 11.1 Projektimi dhe planifikimi i interkoneksionit duhet te jete ne perputhje me Planifikimin e Rrjetit te rene dakord mes TELEKOM ALBANIA dhe Operatorit Perfitues. Planifikimi i Rrjetit do te jete i vlefshem per (2) vjet rradhazi dhe duhet te pergatitet nga te dyja Palet bashkarisht.
- 11.2 Planifikimi i Rrjetit duhet te rishikohet dhe te azhurnohet nga TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues ne nje interval kohor te rene dakord nga perfaqesuesit teknike dhe komerciale te te dyja Paleve.
- 11.3 Perveç pergatitjes se Planifikimit te Rrjetit, TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues duhet te hartojne parashikimet per Lidhjet e Interkoneksionit. Proçedurat e Parashikimit te Nyjeve te Interkoneksionit jane pershkruar ne Aneksin VI (Kapaciteti dhe procedurat e parashikimit te kapacitetit te interkoneksionit) te kesaj ORI. Parashikimi i rene dakord mes Paleve do te konsiderohet si pjese e Planifikimit te Rrjetit.
- 11.4 Parashikimet e dhena nga TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues perfaqesojne pritshmerite ne mirebesim te seciles prej paleve ne lidhje me kerkesat per kapacitetin e Lidhjeve te Interkoneksionit.
- 11.5 Si TELEKOM ALBANIA, ashtu dhe Operatori Perfitues, gezojne te drejten qe te shlyhen nga njeri-tjetri per çfaredolloj kosto te pashmangshme qe ka ardhur si rezultat i ndonje mosperdorimi ne kapacitetin e porositur, ne perputhje me proçedurat e parashikimit te percaktuara ne Aneksin VI (Kapaciteti dhe procedurat e parashikimit te kapacitetit te interkoneksionit).

12. MODIFIKIMI I RRJETIT DHE NDRYSHIMET NE ADMINISTRIMIN E TE DHENAVE




Diagrama e Procedures per Ndryshimin e Rrjetit

-
- 12.1 Secila pale mund te kerkoje Ndryshim te Rrjetit, duke derguar njoftim te pala tjetër te pakten tre (3) muaj kalendarike para dates se planifikuar per fillimin e implementimit te ndryshimit te propozuar. TELEKOM ALBANIA, nese ndodhet ne poziten per te pranuar Ndryshimin e propozuar te Rrjetit, do te jape nje vleresim te kostove te perfshira ne ndryshim brenda nje (1) nje Muaji Kalendarik nga marrja e kerkeses per Ndryshim Rrjeti.
- 12.2 Operatori Perfitues, *pervec rastit kur Modifikimi i Rrjetit eshte miratuar ose kur eshte pjese e nje programi permiresimi te planifikuar*, do te paguaje shpenzimet e TELEKOM ALBANIA, ne ato raste kur ndryshimet detyrojne TELEKOM ALBANIA te ndryshoje sistemin e tij ne menyre qe te percjelle thirrjet. Ne ato raste kur Modifikimi i Rrjetit miratohet bashkarisht dhe eshte ne te mire dhe perfitim te te dy paleve, apo kur ka nje perfitim financiar qe mblidhet ne interes te TELEKOM ALBANIA, Modifikimi i Rrjetit do te kryhet duke u bazuar ne ndarjen e kostove te ngarkuara..
- 12.3 Ndryshimet e Rrjetit do te kryhen brenda shkalles kohore te paraqitur ketu ne Nenin 12. Nese TELEKOM ALBANIA nuk mendon se ndodhet ne poziten per te proceduar me Ndryshimin e Rrjetit, qofte permes shkalles kohore se kerkuar apo ne çfaredo rrethane tjetër, do te njoftoje Operatorin Perfitues brenda dy (2) javesh nga marrja e kerkeses. Ne keto rrethana TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues do bejne gjithë perpjekjet e mundshme dhe te arsyeshme per te zgjidhur situaten, duke perfshire dhe adresimin e çeshtjes ne procesin e zgjidhjes se mosmarreshjeve sipas nenit 19 (Zgjidhja e Mosmarreshjeve).
- 12.4 TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues do te perpiqen te minimizojne numrin e Ndryshimit te Menaxhimit te te Dhenave ne Rrjetin e njeri-tjetrit.
- 12.5 Ne menyre qe te sigurohet implementimi ne kohe i Ndryshimeve te Menaxhimit te te Dhenave, njoftimi per Ndryshimin e Menaxhimit te te Dhenave duhet te jepet nga Operatori Perfitues qe kerkon ndryshimin te pakten dy (2) Muaj Kalendarik para dates se kerkuar te implementimit.
- 12.6 Ndryshimet e Menaxhimit te te Dhenave do te kryhen brenda shkalles kohore te parashtruar ne kete Nen 12. Nese TELEKOM ALBANIA nuk mendon se eshte ne poziten per te proceduar me Ndryshimin e Rrjetit, qofte permes shkalles kohore se kerkuar apo ne çfaredo rrethane tjetër, do te njoftoje Operatorin Perfitues brenda dy (2) javesh nga marrja e kerkeses. Ne keto rrethana TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues do bejne gjithë perpjekjet e mundshme te arsyeshme per te zgjidhur situaten, perfshi edhe adresimin e çeshtjes ne procesin e zgjidhjes se mosmarreshjeve sipas nenit 19 (Zgjidhja e Mosmarreshjeve).
- 12.7 Ndryshimet e Menaxhimit te te Dhenave qe kerkojne aktivizimin e ri gjeografik apo te Serite Numerike te klientit, te shperndare ose ndryshuar nga AKEP, do te kryhet pa pagese.
- 12.8 Ne lidhje me kerkesat e tjera te Ndryshimeve te Menaxhimit te te Dhenave, kur miratohen bashkarisht dhe eshte ne interesin e perbashket te paleve, ose kur ka nje perfitim financiar qe mblidhet ne interes te TELEKOM ALBANIA, Ndryshimet e

Menaxhimit te te Dhenave do te kryhen duke u bazuar ne ndarjen e kostove te ngarkuara.

13. SIGURIA E PERSONELIT DHE INSTALIMEVE / RUAJTJA E INTEGRITETIT TE RRJETIT

- 13.1 Secila Pale ne kuadrin e interkoneksionit mes rrjetit te saj dhe rrjetit te Pales tjeter, duhet te garantoje dhe te mbroje, duke marra masa praktike, integritetin e rrjetit te vet, ne menyre qe te ofroje funksionimin e pacenuar te rrjeteve te nderlidhura. Asnje nga Palet nuk do te kryeje, ose lejoje te kryhet, asgje qe mund te demtoje apo te ndikojte ne menyre te demshme rrjetin e vet.
- 13.2 Secila Pale do te garantoje funksionimin e sigurt te rrjetit te saj dhe do te ndermarre çdo mase te nevojshme dhe te arsyeshme per zbatimin e Interkoneksionit sipas kesaj ORI, ne menyre qe te siguroje se rrjeti:
- a. Nuk perben asnje rrezik per sigurine e shendetit te personelit dhe klienteve te vet apo te Pales tjeter, dhe
 - b. Nuk sjell demtime, interferenca apo defekte ne funksionimin e rrjetit te Pales tjeter.
- 13.3 Asnje nga palet nuk do te lidhe apo do te lejoje me dijene interkonektimin ne rrjetin e tij te ndonje pajisje, aparati, perfshire por jo vetem, me ndonje pajisje terminimi qe nuk eshte aprovuar, ne perputhje kjo me Ligjin 9918, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.331, datë 14.4.2011 “Per miratimin e Rregullit Teknik “Per kerkesat thelbesore dhe vleresimin e konformitetit te pajisjeve radio dhe fundore te telekomunikacioneve’ dhe aktet e tjera nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij dhe Rregulloren ‘Per pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit te tyre’ miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues Nr. 1977, date 14.06.2012 te AKEP.
- 13.4 Çeshtjet lidhur me mbrojtjen e interkoneksionit te nevojshem dhe instalimit te duhur nga fatkeqesi, katastrofa apo defekte do te trajtohen ne perputhje me rekomandimet perkatese nderkombetare te ITU-T dhe ETSI.

14. NUMERACIONI

- 14.1 Secili Operator i Autorizuar duhet te perdore per abonentet e rrjetit te tij serite numerike qe i jane caktuar ne perputhje me Planin Kombetar te Numeracionit te administruar nga AKEP.
- 14.2 Te dyja Palet jane te detyruara te respektojne dispozitat mbi Numeracionin dhe CLI, te cilat jane te percaktuara ne Aneksin V (Numeracioni dhe CLI)

15. IDENTIFIKIMI I NUMRIT THIRRES

- 15.1 Shfaqja e identitetit te numrit thirres (CLI) duhet te perputhet me te gjitha kerkesat e Ligjit 9918 dhe Rregullores per Aksesin dhe Interkoneksionin.

-
- 15.2 Ne momentin kur njera Pale percjell thirrjet ne rrjetin e Pales tjeter, eshte e detyruar te transmetoje Identitetin e Numrit Thirres, pa e ndryshuar ose fshehur ate, duke perdorur protokollin e sinjalizimit CCS Nr.7.
- 15.3 Te dyja palet jane te detyruara te respektojne dispozitat mbi identitetin e numrit thirres (CLI), sic jane specifikuar ne Aneksin V (Numeracioni dhe CLI)

16. CILESIA E SHERBIMIT

- 16.1 TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues kane detyrimin qe te kujdesen qe sherbimet e interkoneksionit te funksionojne ne perputhje me nenin 102 te Ligjit 9918, dhe aktet e tjera nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij; standartet e pranuar, siç percaktohet nga treguesit e Cilesise se Sherbimit te percaktuar ne seksionet 5, 6 dhe 7 te dokumentit te ETSI TR 101 949 V1.1.1 (2002-07) publikuar ne gjuhen shqipe ne faqen e internetit te AKEP dhe te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Rregullorja 'Per Treguesit e Cilesise se Sherbimit', miratuar me Vendim te AKEP Nr.1256, date 16.04.2010.
- 16.2 Niveli i Cilesise se Sherbimit, afatet per mirembajtjen dhe shfrytezimin, treguesit dhe standartet e cilesise se sherbimit percaktohen ne Marreveshjen e Nivelit te Sherbimit qe nenshkruhet nga Palet ne momentin e nenshkrimit te Marreveshjes se Interkoneksionit, bazuar ne kete ORI.

17. DHENIA E INFORMACIONIT

- 17.1 Ne perputhje dhe me nenin 22 (Ruajtja e konfidencialitetit) te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, njera pale mund ti kerkoje pales tjeter informacion mbi protokollet ne perdorim nga pala tjeter, informacion i cili eshte i nevojshem per interkoneksion, percjellje thirrjesh apo sigurimin e sherbimeve te pershkruara ne marreveshjen e interkoneksionit bazuar ne kete ORI, gjithmone nese pala tjeter ka informacion te nevojshem dhe nese sigurimi i ketij informacioni eshte i domosdoshem si pasoje e mungeses dhe/ose pamjaftueshmerise te standarteve nderkombetare apo atyre te miratuara nga AKEP.
- 17.2 Pavaresisht detyrimeve qe rrjedhin nga marreveshja e interkoneksionit bazuar ne kete ORI, asnje nga palet nuk do jete e detyruar te siguroje informacion i cili eshte subjekt konfidencialiteti i detyrimeve ndaj nje pale te trete, pervecse kur kjo e fundit ka dhene miratimin per nje gje te tille.
- 17.3 Pala dhenese e informacionit do te beje te gjitha perpjekjet e arsyeshme qe te sigurohet se informacioni i dhene eshte me i sakti i mundshem sipas njohurive te saj, ne momentin e dhenies se tij.
- 17.4 Nese pala dhenese i jep informacion pales marrese, atehere pala dhenese do te marre paraprakisht te gjitha miratimet e nevojshme nga palet e treta.

- 17.5 Pala marrese e informacionit do te demshperbleje palen dhenese dhe do dhe do te garantoje demshperblimin kundrejt te gjithë pergjegjesive, padive, kerkesave, demeve te pretenduara, kostove apo shpenzimeve qe kane lindur si pasoje e deshtimit nga ana e pales marrese per te vepruar ne perputhshmeri me keto kushte, perfshire ato te permendura ne nenin 22 (Ruajtja e konfidencialitetit) te Marreveshjes se Interkoneksionit, nga pala dhenese apo nga ndonje pale e trete ne momentin qe informacioni eshte dhene.
- 17.6 Per te shmangur cdo dyshim, asgje ne marreveshjen e interkoneksionit bazuar ne kete ORI, nuk do te detyroje ndonje nga palet qe te veproje ne kundershtrim me detyrimet kontraktuale te konfidencialitetit.

18. PERDORIMI ABUZIV I MARREVEESHJES SE INTERKONEKSIONIT

- 18.1 Lidhjet e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, do te perdoren nga secila Pale ekskluzivisht, sic eshte rene dakord paraparakisht, per sherbimet dhe menyren operative te tyre, sic jane parashikuar ne kete ORI.
- 18.2 Palet bien dakort qe te bejne te gjitha perpjekjet e nevojshme per zbulimin, identifikimin dhe eliminimin e çdo rritjeje artificiale te trafikut per shkak te ndonje veprimi abuziv nga pale te treta dhe per shkembimin e informacionit ne lidhje me bashkepunimin brenda masave te caktuara per parandalimin e shfaqjes se abuzimeve te tilla ne rrjetet perkatese te Paleve dhe eliminimin e tyre.
- 18.3 Shkelja e dispozitave te percaktuara ne pikat 18.1 dhe 18.2 te ketij neni konsiderohet si perdorim abuziv.
- 18.4 Me kerkese te Pales se cenuar qe identifikon nje ose me shume situata perdorimi abuziv, Pala tjeter eshte e detyruar te korrigoje situaten dhe te jape nje pergjigje brenda nje afati 10-ditor nga marrja e pretendimit. Nese abuzimi vazhdon, Pala e cenuar do te ndjeke te gjithë procedurat per zgjidhjen e mosmarreveshjes sipas parashikimeve te Rregullores se Akses Interkoneksionit dhe nenit 19 (Zgjidhja e mosmarreveshjeve) te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI.

19. ZGJIDHJA E MOSMARREVEESHJEVE

- 19.1 Dispozitat e ketij neni jane te zbatueshme ne rast te mosmarreveshjeve qe lindin mes Operatorit Perfitues dhe TELEKOM ALBANIA ne lidhje me, ose per shkak te Marreveshjes se Interkoneksionit, perfshire ketu lidhjen, implementimin, zbatimin, interpretimin, amendimin, perfundimin dhe zgjidhjen e Marreveshjes se Interkoneksionit, me perjashtim te ceshtjeve qe lidhen me faturimin dhe pagesat dhe CLI, te cilat trajtohen sipas Aneksit IV (Faturimi dhe Pagesat) dhe nenit 20 me poshte. Palet duhet te perpiqen te arrijne zgjidhjen e Mosmarreveshjes me mirekuptim mes tyre brenda nje periudhe prej 10 (dhjete) ditesh, pervec se kur palet kane rene dakord per nje afat ndryshe, nga marrja e

-
- njoftimit me shkrim per Mosmarveshjen, i cili dergohet nga pala jo ne shkelje tek pala tjeter.
- 19.2 Ne rast te nje mosmarveshje qe lind mes Operatorit Perfitues dhe TELEKOM ALBANIA ne lidhje me aksesin dhe interkoneksionin, si dhe me perdorimin e perbashket te faciliteteve dhe asetave ndermjet sipermarresve, palet do te zbatojne dispozitat e 'Rregullores per procedurat e zgjidhjes se mosmarveshjeve' miratuar me VKD te AKEP nr 1296 date 11.06.2010
- 19.3 Ne rast te nje mosmarveshje qe lind mes Operatorit perfitues dhe TELEKOM ALBANIA ne lidhje me modifikimin apo fshehjen e CLI te thirrjeve, palet do te zbatojne dispozitat e parashikuara ne Rregulloren per Akses dhe Interkoneksionin, perkatesisht neni 5 (i ndryshuar)
- 19.4 Per cdo rast tjeter ne lidhje me ose per shkak te Marveshjes se Interkoneksionit, perjashto cfare parashikohet ne pikat 19.2 dhe 19.3, palet do t'i drejtohen AKEP per zgjidhjen e ceshtjes ne perputhje me nenin 120 te Ligjit Nr. 9918, Ligjin Nr. 8485, date 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative" si dhe aktet nenligjore ne zbatim te tyre
- 19.5 Pavaresisht procedurave per zgjidhje te mosmarveshje te parashikuara ne kete ORI apo te rena dakort ne marveshjen e interkoneksionit te lidhur midis paleve, secila nga palet ka te drejte qe ne cdo kohe t'ia adresojte ceshtjen AKEP per zgjidhje, ne perputhje me nenin 120 te Ligjit Nr.9918.
- 19.6 Secila nga palet ka te drejte t'i drejtohet per zgjidhje organeve gjyqesore perkatese pasi te jete ezauruar rekursi administrativ, pervec rasteve kur objekti i mosmarveshjes lidhet me pagesat e percaktuara ne RIO dhe MI. Ne rast mosmarveshje per ceshtje te pagesave te percaktuara ne kete RIO dhe MI e lidhur midis paleve, palet bejne perpjekje per zgjidhjen e tyre ne mirkuptim, ose mund te perdorin te drejtat e tyre per zgjidhje nepermjet arbitrazhit, ndermjetesimit ose shqyrtimit gjyqesor te saj, sipas zgjedhjes se seciles pale. Gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarveshjeve eshte ajo e percaktuar ne dispozitat perkatese te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise..

20. SHKELJA, PEZULLIMI DHE ZGJIDHJA E MARREVEESHJES SE INTERKONEKSIONIT

- 20.1 Ne rast se rrjeti i njeres Pale ndikon negativisht ne funksionimin normal te rrjetit te Pales tjeter, ose paraqet rrezik per sigurine e ndonje personi, Pala tjeter mund te pezulloje, ne masen qe gjykohet e nevojshme, detyrimet e saj te lindura nga Marveshja e Interkoneksionit e lidhur ne baze te kesaj ORI, per ate periudhe kohe qe mendohet e arsyeshme per te siguruar funksionimin normal te sistemeve te saj ose per te ulur shkallen e rrezikut ndaj sigurise. Ne cdo rast, pala qe ndermerr masen e pezullimit njofton me shkrim edhe AKEP.
- 20.2 Nese nje Pale ka kryer shkelje te Marveshjes se Interkoneksionit te lidhur ne baze te kesaj ORI, pervec rasteve te parashikuara ne pikat 20.11 deri 20.14, Pala jo ne shkelje

-
- mund t'i dergoje nje njoftim me shkrim Pales tjeter qe ka kryer shkeljen (Njoftimin per Shkelje) duke specifikuar shkeljen dhe duke kerkuar qe ajo te korrigjohet brenda:
- 20.2.1 Dhjete (10) ditesh nga dita e marrjes se njoftimit per shkelje. Perjashtim ben rasti kur shkelja ka te beje me modifikimin dhe/ose fshehjen e CLI te thirrjeve, rast ne te cilin palet do te zbatojne percaktimet e Rregullores per Akses dhe Interkoneksion dhe Aneksin V (Numeracioni dhe CLI) te kesaj ORI.
- 20.2.2 Ne raste emergjente, pervec detyrimeve financiare, brenda nje periudhe me te shkurter se 10 (dhjete) dite te cilen Pala jo ne shkelje do t'a percaktoje ne menyre te arsyeshme.
- 20.3 Nese Pala qe ka kryer shkeljen nuk arrin t'a korrigjohet kete shkelje brenda periudhes se percaktuar ne paragrafin 20.2, Pales tjeter i lind e drejta qe, derisa shkelja te jete korrigjuar, te pezulloje kryerjen e detyrimeve te saj, perfshire ofrimin e sherbimeve te interkoneksionit, te lindura nga Marreveshja e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, ne masen qe konsiderohet e arsyeshme ne rrethana te tilla.
- 20.4 Nese Pala qe ka kryer shkeljen nuk arrin t'a korrigjohet kete shkelje brenda periudhes se percaktuar ne njoftimin per shkeljen, Pales tjeter i lind e drejta per zgjidhjen e Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI me ane te nje njoftimi paraprak 3 mujor, me shkrim, te derguar tek Pala qe ka kryer shkeljen. Ne qofte se gjate periudhes 3 mujore te njoftimit Pala qe ka kryer shkeljen arrin t'a korrigjohet shkeljen dhe te shlyeje plotesisht demin e shkaktuar nga kjo shkelje, kjo Marreveshje nuk do te zgjidhet edhe pas dergimit te nje njoftimi te tille.
- 20.5 Secila nga Palet mund t'a zgjidhe Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, duke i dhene pales tjeter njoftim me shkrim, nese pala tjeter ndodhet ne kushtet e:
- 20.5.1 Perfundimit te afatit, anullimi dhe raste te tjera te perfundimit te parakohshem te licences ose autorizimit, kur nje license ose autorizim i tille kerkohet me ligj; ose,
- 20.5.2 Likuidimit te vullnetshem ose te detyruar (pervec se per qellime riorganizimi ose bashkimi te bizneseve); ose është deklaruar në falimentim; ose
- 20.5.3 Mbylljes se aktivitetit para afatit te perfundimit te marreveshjes;ose
- 20.5.4 Njoftimit nga pala qe zgjidh marreveshjen, per ndërprerjen e Marreveshjes se Interkoneksionit në mënyrë të njëanshme për arsye të parashikuara në këtë ORI;
- 20.5.5 Mos-ndryshimit, mos-plotesimit apo mos-rinovimit te garancise financiare sipas percaktimeve ne seksionin 21 'Garancia Financiare'.
- 20.6 Me zgjidhjen ose perfundimin e rregullt te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, secila nga Palet gezon te drejten qe, pas dergimit tek Pala tjeter te nje njoftimi paraprak brenda nje afati te arsyeshem, te hyje ne ambientet e Pales tjeter me qellim kryerjen e procedurave te nevojshme per çmontimin dhe rimarrjen ne dorezim te pajisjeve, impianteve ose aparaturave qe i perkasin kesaj te fundit (ose nje Pale te trete te

-
- instaluar nga ose per ate Pale), me kusht qe Pala qe kerkon te hyje ne keto ambiente te jape nje njoftim tjeter brenda nje afati te arsyeshem duke kerkuar qe Pala tjeter te kryeje çmontimin dhe kthimin e ketyre pajisjeve impianteve dhe aparaturave dhe te hyje ne keto ambiente vetem ne rast se vete ajo Pale nuk e ka bere kete. Pala, ne ambientet e se ciles jane instaluar keto pajisje, impiante dhe aparatura do te kompensoje Palen tjeter per çdo pajisje, impiant dhe aparature qe i perket Pales tjeter ose ndonje pale te trete, te cilat nuk dorezohen ne kushte te mira (nje shkalle e lehte amortizimi eshte e pranueshme). Pala ku jane montuar pajisjet nuk do te konsiderohet pergjegjese per ndonje demtim te pajisjeve, impianteve dhe aparaturave qe i perkasin Pales tjeter ose nje Pale te trete, demtim i cili eshte shkaktuar nga moskryerja e procedurave te nevojshme te mirembajtjes nga Pala tjeter ose Pala e trete.
- 20.7 Pa cenuar te drejtat e Paleve, me zgjidhjen e Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, secila nga Palet do t'i rimbursoje Pales tjeter shumate e paguara (nese ka te tilla) per periudhen e kohes qe tejkalon afatin e vlefshmerise se Marreveshjes se Interkoneksionit.
- 20.8 Zgjidhja e Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI nuk do te nenkuptoje shkarkimin e pergjegjesise se njeres nga Palet e ketushme per shkeljen e ndonjeres prej dispozitave te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI dhe do te behet pa cenuar te drejtat dhe detyrimet e asnjeres prej Paleve, te cilat kane lindur dhe jane akumuluar deri ne daten e zgjidhjes se kesaj Marreveshje ose perfundimit te saj te rregullt.
- 20.9 Pavaresisht zgjidhjes apo perfundimit te Marreveshjes se Interkoneksionit qe bazohet ne kete ORI, detyrimet qe lindin nga nenet 17, 20.6, 22, dhe 26 do te vazhdojne te mbeten ne fuqi per nje afat 10 (dhjete) vjecar, pervec se kur palet me shkrim kane parashikuar ndryshe.
- 20.10 Pavaresisht sa parashikohet ne kete nen per nderprerje apo zgjidhje te interkoneksionit, pala qe ka marre nje Njoftim per Shkelje, sipas pikes 20.2 ka te drejte te paraqese ceshtjen ne AKEP per zgjidhje mosmarreveshje sipas afateve te parashikuara nga ligjet dhe rregulloret ne fuqi. Ne kete rast, masat ne dispozicion te pales qe pretendon shkeljet e referuara ne kete nen, pervec rasteve te parashikuara ne pikat 20.11 deri 20.14 dhe nenin 21, ndaj pales tjeter nuk do te aplikohen per sa kohe AKEP nuk ka marre vendim per ceshtjen e referuar.
- 20.11 Ne rast se ndonje nga palet deshton te kryeje pagesat e sherbimeve sipas percaktimeve te dhena ne Aneksin III (Faturimi dhe Pagesat), neni 3.7.2, nje shkelje e tille do te konsiderohet Shkelje pagesash' dhe do te perbeje shkak per zgjidhjen e marreveshjes, sipas procedures ne vijim. Pala jo ne shkelje ka te drejte te veproje ne nje prej menyrave te meposhtme (20.11.1 ose 20.11.2), kjo sipas deshires se pales qe nuk eshte ne shkelje :
- 20.11.1 Te filloje ekzekutimin e menjehershme te Garancise Bankare te vendosur nga pala tjeter sipas percaktimeve ne nenin 21 (Garancia Bankare) dhe pas ekzekutimit te njoftoje me shkrim palen tjeter duke kerkuar qe brenda 10 (dhjete) diteve kalendarike:

-
- a. te plotesoje vleren e Garancise Bankare, pas perdorimit nga pala jo ne shkelje, ne vleren e meparshme ose ne nje vlere te rivleresuar nga pala jo-ne shkelje;
- b. te paguaje diferencen midis vleres se detyrimit financiar perkates dhe Garancise Bankare, ne rast se Garancia Bankare nuk mbulon vleren e ketij detyrimi.
- 20.11.2 Te pezulloje ofrimin e sherbimeve te interkoneksionit duke njoftuar 5 dite para palen ne shkelje per masen e marre, me te drejten per te zgjidhur marreveshjen e interkoneksionit sipas percaktimeve te pikes 20.13
- 20.12 Ne rast se pala ne shkelje korrigjon shkeljen brenda afatit kohor te percaktuar sipas 20.11, pala jo ne shkelje nuk do te zgjidhe marreveshjen e interkoneksionit, me kusht qe percaktimi ne piken 20.14 nuk aplikohet.
- 20.13 Deshtimi apo refuzimi nga pala ne shkelje per te korrigjuar ‘Shkeljen e Pagesave’ edhe pas pezullimit te percaktuar sipas 20.11.2 i jep te drejten pales jo-ne shkelje qe te zgjidhe marreveshjen e interkoneksionit, me njoftim paraprak 5 ditore me shkrim.
- 20.14 Ne rast se, nje pale qe eshte njoftuar per tre shkelje te pagesave te meparshem, jo detyrimisht te njepasnjeshme, ndodhet ne kushtet e nje shkelje pagesash per here te katert brenda nje periudhe 24 (njezet e kater) mujore, marreveshja e interkoneksionit mund te zgjidhet nga pala jo ne shkelje nepermjet nje njoftimi me shkrim derguar pales ne shkelje. Zgjidhja e Marreveshjes se interkoneksionit do te realizohet 30 (tridhete) dite pas dates se dergimit te njoftimit. Zgjidhja e marreveshjes mund te kryhet pavaresisht nese ‘Shkelja e Pagesave’ eshte korrigjuar gjate kesaj periudhe kohore. Detyrimet per pagesa ngelen edhe pas zgjidhjes se marreveshjes se interkoneksionit.
- 20.15 Palet kane detyrimin te njoftojne AKEP menjehere ne secilin prej ketyre rasteve te permendura nenin 20, perjashto rastet e shkeljeve te pagesave dhe Garancise Bankare, si dhe per rastet e nderprerjeve per shkak te forcave madhore dhe emergjences.

21. GARANCIA BANKARE

- 21.1 Ne momentin e nenshkrimit te Marreveshjes se Interkoneksionit, njera pale i siguron Garanci Bankare pales tjeter. Garancia Bankare do te jete sipas formatit te garancise percaktuar ne Aneksin VII (Garancia Bankare), per ofrimin e sherbimeve te interkoneksionit, ne perputhje me kete ORI.
- 21.2 Vlefshmeria e Garancise Bankare eshte per nje periudhe 12 (dymbedhete) mujore, duke filluar nga dita e nenshkrimit te Marreveshjes, ne perputhje me kete ORI.
- 21.3 Nje muaj perpara dates se perfundimit te periudhes se vlefshmerise se garancise, pala qe ka siguruar Garancine, ka detyrimin te dorezoje nje Garanci bankare te re te pala tjeter. Pas dorezimit te Garancise Bankare te re, pala perfituese e Garancise Financiare do t'i ktheje pales tjeter Garancine Bankare pararendese. Deshtimi per te rinovuar apo dhene nje garanci te re brenda afatit, i jep pales tjeter te drejten te nderprese interkoneksionin dhe te zgjidhe Marreveshjen.

-
- 21.4 Pala qe depoziton Garancine Bankare do te jete e detyruar qe perpara nenshkrimit te Marreveshjes se Interkoneksionit, te kete derguar te pala tjeter Garancine Bankare sipas formatit te percaktuar ne Aneksin VII.
- 21.5 Garancia Bankare duhet te jete leshuar nga nje Banke e nivelit te dyte qe ushtron aktivitetin ne Shqiperi.
- 21.6 Shuma e Garancise Bankare do te perlllogaritet ne menyre te tille qe te mbuloje detyrimin neto ndaj TELEKOM ALBANIA /Operatorit Perfitues per nje periudhe dy-mujore trafiku. Detyrimi neto perlllogaritet si diference e detyrimit te Operatorit Perfitues ndaj TELEKOM ALBANIA me detyrimin e TELEKOM ALBANIA ndaj Operatorit Perfitues per trafikun e shkembyer. Vlera e periudhes dy mujore do te jete e barabarte me dyfishin e vleres mesatare 1 mujore te 12 muajve:
- 21.6.1 per operatoret qe kane interkoneksion ekzistues: $(6 \text{ muajt e meparshem} + \text{parashikimi per } 6 \text{ muajt ne vijim})/6$,¹
- 21.6.2 per operatore te rinj : $(\text{parashikimi per } 12 \text{ muajt ne vijim})/6$
- 21.7 Ne rast se detyrimi neto ndaj Operatori Perfitues eshte negativ, TELEKOM ALBANIA do te vendose nje Garanci Financiare sipas perlllogaritjeve te mesiperme, ne rast se kjo do te kerkohet shprehimisht nga Operatori Perfitues.
- 21.8 Vlera e Garancise si rregull do te rishikohet 1 (nje) here ne vit, si dhe ne rastet e ndryshimeve te ndjeshme te volumeve te trafikut, te cilat konsiderohen ndryshim i detyrimeve neto te dy muajve te fundit nga vlera e Garancise Bankare minimalisht ne masen 30%
- 21.9 Ne çdo rast, shuma ne Garanci qe do te llogaritet si me siper dhe do t'i dorezohet TELEKOM ALBANIA /Operatorit Perfitues, nuk mund te jete me pak se detyrimi neto maksimal i nje muaji.
- 21.10 Mospermbushja e percaktimeve ne kete nen nga pala qe siguron Garancine Bankare, do te konsiderohet arsye per zgjidhjen e marreveshjes se interkoneksionit, sipas nenit 4 dhe dispozitave ne nenin 20, perkatesisht 20.11 - 20.15 (Shkelja, pezullimi dhe zgjidhja e marreveshjes se interkoneksionit) ne kete Oferte Reference Interkoneksioni..
- 21.11 Garancia Bankare, siç perkufizohet ne paragrafet e mesiperme, do te ekzekutohet pjeserisht apo teresisht ne raste mospagese ne kohe te shumave neto qe njera pale i detyrohet pales tjeter per sherbimet e interkoneksionit te ofruara ne perputhje me Marreveshjen e Interkoneksionit te lidhur sipas kesaj ORI.
- 21.12 Pas perdorimit te Garancise Bankare, ajo do te duhet te rikthehet ne shumen e meparshme nga pala qe ka siguruar Garancine. Moskthimi ne shumen origjinale i jep te drejten pales tjeter te nderprese sherbimet e interkoneksionit te ofruara me marreveshjen e

¹ Per operatore qe kane me pak se 6 muaj interkoneksion $(N+P)/6$, ku N-numri i muajve qe kane interkoneksion, dhe $P=12-N$, muajt e parashikuar.

interkoneksionit bazuar ne kete ORI, sipas dispozitave ne nenin 20., perkatesisht 20.11 – 20.15 (Shkelja, pezullimi dhe zgjidhja e Marreveshjes se Interkoneksionit)

- 21.13 Ne rastin e zgjidhjes apo perfundimit te Marreveshjes se Interkoneksionit mes paleve perpara perfundimit te afatit 12 mujor te garancise, Garancia Bankare do t'i kthehet pales e cila ka bllokuar shumen e caktuar, pasi kjo e fundit te kete bere nje kerkese me shkrim per zhbllokimin e kesaj Garancie. Ne kete rast garancia bankare do te zhbllokohet vetem pasi pala qe ka bllokuar shumen, te kete shlyer cdo detyrim sipas Marreveshjes se Interkoneksionit, subjekt i se ciles eshte kjo Garanci Bankare.

22. RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT

- 22.1 TELEKOM ALBANIA, ne kuadrin e Marreveshjes se Interkoneksionit, ofron per Operatorin Perfitues informacion ne lidhje me strukturen e vet, organizimin dhe veprimtarine (ne vijim Informacioni Konfidencial). Informacioni i mesiperm, ne çdo forme dhe nese i eshte dhene Operatorit Perfitues, ka absolutisht karakter konfidencial dhe behet i ditur nga TELEKOM ALBANIA me qellimin e vetem te perfitimit te sherbimeve percaktuar ne Aneksin II. Operatori Perfitues garanton ruajtjen e karakterit konfidencial te informacionit te marre nga TELEKOM ALBANIA. Informacioni konfidencial do te konsiderohet ai qe jepet si “i tille”. Ne asnje rast TELEKOM ALBANIA nuk eshte pergjegjes ndaj Operatorit Perfitues per sakesine ose plotesine e Informacionit Konfidencial.
- 22.2 Operatori Perfitues do te perdore Informacionin Konfidencial vetem per qellimin e permbushjes se detyrimeve te kesaj Marreveshjeje, dhe po ne kete kuader do t'ua beje te ditur punonjesve te tij, bashkepunetoreve, nenkontraktoreve, te cilet me miratimin e Operatorit Perfitues do te kene akses per permbushjen e qellimit te mesiperm. Operatori Perfitues bie dakort te ndermarre te gjithë masat e nevojshme, ne menyre qe fshehtesia e vendosur per Informacionin Konfidencial te zbatohet nga nenkontraktoret e tij. Operatori Perfitues nuk do t'u siguroje Informacion Konfidencial, qe mund te sillte avantazh ne konkurrence, kompanive bija apo partnereve te tij.
- 22.3 Per arsyet e lartpermendura, Nenkontraktoret qe do te perdoren nga Operatori Perfitues, do te informohen dhe paraprakisht do te perkushtohen ne zbatimin e detyrimeve te mesiperme per sa i takon Informacionit Konfidencial. Pervec kesaj, Operatori Perfitues ka per detyre te informoje nenkontraktoret e vet ne lidhje me pergjegjesite morale dhe penale ne rast shkelje te ndonje detyrimi qe lind nga kjo Marreveshje Interkoneksioni. Informacioni Konfidencial i mesiperm do te manaxhohet nga Operatori Perfitues, ne masen e nevojshme lidhur zbatimin e Marreveshjes se Interkoneksionit.
- 22.4 Dispozitat e mesiperme ne lidhje me informacionin nuk do te jene te zbatueshme ne rastin kur:
- 22.4.1 Informacioni eshte perfituar nga nje pale e trete pa vendosjen e ndonje kufizimi ne lidhje me zbulimin dhe/ose perdorimin;

-
- 22.4.2 Informacioni perfitohet ne menyre tjeter ose behet i detyrueshem per t'ju dhene Institucioneve te Tjera sipas legjislacionit ne fuqi.
- 22.5 Operatori Perfitues do ti ktheje TELEKOM ALBANIA çdo Informacion Konfidencial dhe, nese ka te tilla, çdo kopje te ketij informacioni ne perfundim te Marreveshjes ose ne rastet kur kerkohet me shkrim nga TELEKOM ALBANIA.
- 22.6 Ne çdo rast, Operatori Perfitues eshte i detyruar t'i permbahet teresisht dispozitave te konfidencialitetit lidhur me informacionin dhe mos t'ua zbuloje (beje te ditur) ate, ne menyre te drejperdrejte ose jo, verbalisht apo me shkrim apo ne ndonje menyre tjeter personave te trete, pa marre me pare miratimin me shkrim te TELEKOM ALBANIA.
- 22.7 Operatori Perfitues eshte pergjegjes per çdo dem qe lind nga shkelja e detyrimeve Konfidencialitetit te Marreveshjes se Interkoneksionit. Ne rast shkelje te detyrimeve te Konfidencialitetit nga ana e nenkontraktoreve te tij apo paleve te treta, Operatori Perfitues do te jete teresisht pergjegjes bashke me ta.
- 22.8 Informacioni Konfidencial, ne te cilin do te kete akses Operatori Perfitues, mund te permbaje gjithashtu te dhena personale te Abonenteve te TELEKOM ALBANIA. Per kete arsye ndalohet rreptesisht kalimi apo berja e ditur e ketij informacioni nga Operatori Perfitues drejt paleve te treta. Aksesit per te dhenat e mesiperme lejohet vetem per nevojat e zbatimit te Marreveshjes se Interkoneksionit dhe nga personat konfidencial te Operatori Perfitues te cilet:
- Do te ofrojne garanci te mjaftueshme nga ana e njohurise teknike dhe integritetit personal ne zbatimin e ruajtjes se konfidencialitetit.
 - Do te jene nen vezhginin e drejteperdrejte te perfaqsesve ligjore te Operatorit Perfitues ose te autorizuar nga ai.
 - Do te jene informuar dhe kane rene dakort paraprakisht per konfidencialitetin e te dhenave ne fjale dhe per detyrimin per te zbatuar dispozitat e Ligjit nr 9887 date 10.03.2008 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale" dhe kuadrit nenligjor plotesues.
 - Do te jene pergjegjes ndaj TELEKOM ALBANIA dhe paleve te treta per çdo shkelje te detyrimeve qe lindin nga dispozitat e Ligjit nr 9887, date 10.03.2008 Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale dhe kuadrit nenligjor plotesues.
- 22.9 Operatori Perfitues garanton se te dhenat e Abonenteve te TELEKOM ALBANIA, te cilat ai perpunon apo u behen te ditura dhe u transmetohen nenkontraktoreve, nuk do te transmetohen, rishiten dhe as nuk do t'u komunikohen paleve te treta per qellime komerciale apo marketingu (si p.sh., promovimi i produkteve etj.) dhe as nuk do te perdoret nga vete Operatori Perfitues ose pale te treta per komunikime dytesore (ne menyre fonetike (me ze) ose permes SMS/MMS-ve) me Abonentet e TELEKOM ALBANIA ne çdo moment kohor.

-
- 22.10 Ekzistenca, permbajtja e Marreveshjes se Interkoneksionit, informacioni i dhene gjate kohezgjatjes se saj dhe diskutimet lidhur me te jane konfidenciale dhe nuk i jepen asnje pale te trete pa marre me pare miratimin me shkrim nga pala tjeter ne kete Marreveshje.
- 22.11 Shkelja e detyrimeve te mesiperme perben shkak per zgjidhjen e menjehershme te marreveshjes mes Operatorit Perfitues dhe TELEKOM ALBANIA ose zgjidhjen e menjehershme te çdo marreveshje tjeter te mundshme mes tyre sipas percaktimeve te kesaj ORI dhe kuadrit ligjor ne fuqi. Ne kete rast TELEKOM ALBANIA gezon te drejten te kerkoje çdo te drejte te parashikuar me ligj dhe ne menyre te veçante te drejten per demshperblim.
- 22.12 Kushtet e mesiperme qendrojne ne fuqi per palet kontraktuale edhe pas perfundimit te Marreveshjes se Interkoneksionit sipas afatit te percaktuar ne nenin 20.9 me lart.
- 22.13 Ne rast se ne Rrjetin e seciles pale rezulton nevoja per hetimin e thirrjeve keqdashese, Pala tjeter kontraktuale ka te drejten te kontribuojë ne keto çeshtje, sipas rendit te perparemise, legjislacionit perkates dhe mundesive teknike qe lidhen me sistemin e vet, duke marre parasysh dispozitat e parashtruara ne Nenin 22.8 me lart.

23. TE DREJTAT E PASURISE INTELEKTUALE

- 23.1 Pervec rasteve kur parashikohet ndryshe ne Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, te Drejtat e Pasurise Intelektuale do t'i mbeten Pales qe ka krijuar ose zoteron çfaredo lloj materiali sipas kesaj ORI dhe asnje dispozite e Marreveshjes se Interkoneksionit nuk do te autorizojë ndonje kalim te se drejtes se pronesise, licenses apo ndonje te drejte tjeter ne lidhje me Pasurine Intelektuale nga njera Pale tek tjetra, dhe asnje dispozite e Marreveshjes se Interkoneksionit nuk do te kufizojë te drejtat e asnjërit prej Operatoreve te Licensuar per te zoteruar, perdorur, licensuar, atribuar ose transferuar Pasurine e tyre Intelektuale.

24. RISHIKIMI I MI

- 24.1 Njera nga palet mund kerkoje te modifikojë Marreveshjen e Interkoneksionit sipas kesaj ORI duke derguar nje njoftim per rishikim tek pala tjeter, ne qofte se:
- 24.1.1 Autorizimi i njerës nga palet modifikohet thelbesisht (me ane te nje modifikimi te autorizimit ose me zevendesim te tij); ose,
- 24.1.2 Detyrimet e TELEKOM ALBANIA sipas Rregullores per Akses dhe Interkoneksion modifikohen thelbesisht; ose,
- 24.1.3 Ligji, aktet nenligjore ne zbatim te tij, ose rregulloret per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise pesojne ndonje ndryshim thelbesor me ndikim ne kete Marreveshje; ose,

-
- 24.1.4 Marreveshja e Interkoneksionit permban dispozita te qarta per Rishikimin ose Operatoren e Autorizuar bien dakort me shkrim se do te kete nje Rishikim; ose,
- 24.1.5 Ndodh nje ndryshim thelbesor, qe perfshin nxjerrjen e akteve detyruese nga ndonje organ rregullator, gje qe ndikon ose pritet te ndikojte mjaftueshmerisht ne aspektin komercial ose teknik te Marreveshjes se Interkoneksionit; ose,
- 24.1.6 Ndodh nje ndryshim ne Sherbimet e Interkoneksionit te ofruara nga TELEKOM ALBANIA sipas kesaj ORI
- 24.1.7 Te drejttat dhe detyrimet te parashikuara ne Marreveshjen e Interkoneksionit jane atribuar ose transferuar nga Operatori Perfitues.
- 24.2 Njoftimi per Rishikim paraqet ne menyre te detajuar ceshtjet qe do te diskutohen midis TELEKOM ALBANIA dhe Operatorit Perfitues. Pala qe kerkon modifikimet/shtesat do te njoftoje Palen tjetere ne lidhje me to brenda nje minimumi prej 30 ditesh kalendarike para dates se propozuar per rishikim.
- 24.3 Me dergimin/marrjen e nje njoftimi per Rishikim, TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues do te fillojne menjehere negociatat per zgjidhjen e ceshtjeve ne mirekuptim mes paleve me qellim renien dakort ne lidhje me modifikimet/shtesat perkatese te Marreveshjes se Interkoneksionit. Ben perjashtim rishikimi i Marreveshjes si rrjedhoje e ndryshime te kuadrit ligjor dhe rregullator, implementimi i te cilave eshte i detyrueshem per zbatim nga palet ne Marreveshje.
- 24.4 Nese Palet nuk arrijne nje marreveshje pas nje periudhe maksimale prej 2 muajsh nga data e marrjes se lajmerimit per shqyrtim, ne lidhje me objektin e njoftimit per Rishikim, atehere do te jene te zbatueshme parashikimet e nenit 19 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) te kesaj Oferte Reference
- 24.5 Per te evituar ndonje keqkuptim te mundshem, TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues bien dakort se pavaresisht nga dergimi/marrja e njoftimit per Rishikim, Marreveshja e Interkoneksionit do te vazhdoje te jete ne fuqi.

25. FORCAT MADHORE

- 25.1 Palet nuk do te konsiderohen pergjegjes per ndonje shkelje te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI shkaktuar nga "Forcat madhore". Per kete arsye "Force madhore" do te kuptohet cdo ngjarje apo ndodhi pertej kontrollit te arsyeshem te paleve, perfshire ketu por pa u limituar ne kryengritje ose trazira civile, luftra ose nderhyrje ushtarake, situata te jashtezakonshme ne shkalle kombetare ose lokale, marrje masash ose mungesa e tyre nga Qeveria, ose organe te tjera kompetente, ndonje akt i nxjerre nga Qeveria ose ndonje autoritet tjetere, zbatimi i ligjit, rregulloreve ose urdherat e Qeverise ose ndonje institucioni qeveritar, mosmarreveshje industriale te cfaredolloji (qofshin ato te lidhura ose jo me TELEKOM ALBANIA ose Operatorin Perfitues), zjarret, rrufete,

shperthimet, permbytjet, termetet, rreshqitjet e dheut, kushte atmosferike te jashtezakonshme, veprime ose mosveprime te personave per te cilet asnjera nga palet nuk eshte pergjegjes, ose ndonje shkak tjeter i ngjashem apo i ndryshem, jashte kontrollit te tyre te arsyeshem, me kusht qe keto shkaqe ose rrethana te jene klasifikuar si forca madhore.

25.2 Nese njera nga palet eshte prekur nga pasojat e nje force madhore, atehere ai do te njoftoje palen tjeter sa me pare qe te jete e mundur ne lidhje me situaten e shkakuar nga kjo force madhore. Nese njera nga palet eshte prekur nga ndonje force madhore, ai duhet te beje me pas njoftimin ne lidhje me parashikimin mbi kohezgjatjen dhe masen ne te cilen ai do t'a kete te pamundur te permbushe detyrimet e tij ose se sa me vonese do t'i permbushe ato (njoftimi per forcen madhore).

25.3 Pas mbarimit te efekteve te forces madhore mbi sherbimin, secila nga palet e prekura nga nje force madhore do te njoftoje menjehere palen tjeter ne lidhje me mbarimin e ketyre efekteve.

25.4 Nese si rezultat i nje force madhore, njera nga palet do te kete pengesa ne permbushjen e detyrimeve te tij te parashikuara ne kete ORI, atehere kjo pale, do te permbushe ato detyrime qe mbeten te pacenuara nga forca madhore. Per permbushjen e ketyre detyrimeve te pacenuara nga forca madhore, pala e prekur nga forca madhore do t'i organizoje ose planifikoje burimet e tij ne menyre te tille qe (kur te marra se bashku me detyrimet e tjera kundrejt klienteve te tij dhe paleve te treta) nuk krijojne asnje diskriminim kundrejt pales tjeter.

25.5 Nese njeres prej paleve si rezultat e nje force madhore i jane krijuar pengesa ne nje mase te caktuar per ofrimin e sherbimeve ose faciliteteve qe duhet te ofrohen sipas kesaj ORI, pala tjeter do te çlirohet po ne te njejten mase nga detyrimet e tij per te kryer pagesa per keto sherbime ose facilitete, ose nga permbushja e detyrimeve te tij ne lidhje me çfare parashikohet ne kete ORI.

25.6 Pas njoftimit per nje force madhore dhe ne rast se efektet e kesaj force madhore vazhdojne per:

25.6.1 Nje periudhe prej jo me shume se gjashte (6) muajsh kalendarike ne menyre te panderprere duke filluar nga data e njoftimit per forcen madhore (pavaresisht nga fakti nese eshte dhene ose jo njoftim per mbarimin e efekteve te forces madhore, sipas nenit 24.3) çdo detyrim i prapambetur do te permbushet nga pala qe eshte prekur nga forca madhore, menjehere pasi kjo te jete e mundur pas mbarimit te efekteve te forces madhore, pervec rasteve kur nje permbushje e tille tashme nuk eshte e mundur ose nuk kerkohet me nga pala tjeter;

25.6.2 Nje periudhe prej gjashte (6) muajsh kalendarike ose me shume duke filluar nga data e njoftimit per forcen madhore (dhe kur akoma nuk eshte dhene njoftim per mbarimin e efekteve te forces madhore, sipas nenit 25.2), pala qe merr njoftimin per forcen madhore do te kete te drejte (por jo detyrim) te zgjidhe Marreveshjen e Interkoneksionit duke i dhene pales tjeter njoftim paraprak me shkrim brenda nje periudhe prej jo me pak se tridhjete (30) ditesh pune, me kusht qe ky njoftim te

konsiderohet i pavlefshem ne rast se pala qe ka marre fillimisht njoftimin per forcen madhore merr edhe nje njoftim per mbarimin e efekteve te forces madhore, perpara se te kete skaduar afati tridhete (30) ditore i njoftimit per zgjidhjen e marreveshjes. Nese Marreveshja e Interkoneksionit nuk eshte zgjidhur ne perputhje me dispozitat e ketij neni, cdo detyrim i prapambetur do te permbushet nga pala qe eshte prekur fillimisht nga efektet e forces madhore, menjehere pasi kjo gje te jete e mundur pas mbarimit te efekteve te forces madhore, pervec rasteve kur nje permbushje e tille tashme nuk eshte e mundur ose nuk kerkohet me nga pala tjeter.

26. KUFIZIMI I PERGJEGJESISE

26.1 Detyrimet e Paleve ne lidhje me interkonektimin e rrjeteve te tyre percaktohen nga legjislacioni ne fuqi, autorizimet e tyre dhe Marreveshja e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI. Asnje nga palet nuk do te mbahet pergjegjese, pertej detyrimit per te ushtruar kujdes dhe vemendje te nje operatori kompetent telekomunikacionesh pergjate ushtrimit te detyrimeve te tij ne perputhje me Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI.

26.2 Palet nuk do te konsiderohen pergjegjese ne rast te ndonje kufizimi ose nderprerje te plote te interkoneksionit, nese kjo gjykohet e nevojshme nga nje organ kompetent i telekomunikacionit dhe/ose organ gjyqesor. Ne kete rast, secila nga Palet eshte e detyruar te njoftoje ne kohe Palen tjeter, duke i vene ne dispozicion te gjithe informacionin e mundshem.

26.3 Asnje nga palet nuk do te jete pergjegjese ndaj pales tjeter ne marredhenie kontraktore apo jashte saj, apo per humbje (direkte ose indirekte) te fitimeve, biznesit, fitimeve te paraprirra, shpenzimeve te harxhuara, kostove apo per ndonje humbje indirekte apo te passjelle qe lind ne lidhje me operimin e Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, sido qe kjo humbje te kete ndodhur/ardhur.

27. KALIMI I TE DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TEK TE TRETET

27.1 Pervecse kur palet kane rene dakord me shkrim ndryshe, TELEKOM ALBANIA dhe Operatori Perfitues nuk kane te drejte te transferojne asnje te drejte ose detyrim, qe rrjedh nga Marreveshja e Interkoneksionit, dhe qe percaktohet sipas kesaj ORI, tek palet e treta, pa marre me pare miratim me shkrim nga Pala tjeter.

27.2 Me njoftimin e Pales tjeter, por pa qene nevoja per miratimin e saj, secila nga Palet ka te drejte te transferoje te drejtat dhe detyrimet e saj konvencionale tek nje pale e trete si rezultat e transferimit te autorizimit perkates qe zoteron per ofrimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike dhe/ose ndryshimit te kontrollit ne Kompanine e saj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me kusht qe pala e trete te marre persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet kontraktuale te Pales qe i transferon keto te drejta dhe detyrime. Çdo kosto e gjeneruar nga ky moment e ne vazhdim do te jete plotesisht ne pergjegjesine e kesaj pale te trete.

28. NJOFTIMET

28.1 Te gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera te çfaredo lloji te shkëmbyera mes Paleve ne baze te kesaj Marreveshje do te behen me shkrim

28.2 Te gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera te çfaredo lloji te shkëmbyera mes Paleve ne baze te kesaj Marreveshje do te jepen vetem:

28.2.1 dorazi;

28.2.2 me poste te regjistruar tek adresa zyrtare e Pales marrese;ose

28.2.3 me faks, nese marrja e ketij faksi konfirmohet automatikisht

28.2.4 me poste elektronike, nese vertetohet dergimi i mesazhit dhe marrja nga pala tjeter

28.3 Ky njoftim ose komunikim do te konsiderohet i derguar siç duhet vetem kur merret ne kete menyre nga Pala tjeter.

29. TERESIA E MARREVESHJES

29.1 Marreveshja e Interkoneksionit qe do te nenshkruhet ne zbatim te kesaj ORI, perfaqeson teresisht kuptimin dhe interpretimin e paleve ne lidhje me objektin e kesaj Marreveshje, dhe pervec rasteve kur eshte rene dakord me shkrim ndryshe, zevendeson te gjitha marreveshjet e meparshme, angazhimet, detyrimet, apo perfaqesimet e cfaredo lloji, qofshin verbale apo ne forme te shkruar.

30. HEQJA DORE

30.1 Heqja dore nga ndonje shkelje, ose mospermbushja e ndonjerit prej afateve dhe kushteve qe rrjedhin nga pranimi i kesaj ORI nuk do te interpretohen si heqje dore nga cdo afat dhe/ose kusht tjeter i kesaj ORI. Heqja dore do te jete e vlefshme vetem nese behet me shkrim dhe nenshkruhet nga pala qe njofton heqjen dore.

31. VLEFSHMERIA

-
- 31.1 Pavlefshmeria, mungesa e forces detyruese te ndonjeres prej dispozitave ne Marrevshjen e Interkoneksionit nuk do te kete asnje ndikim mbi vlefshmerine ose forcen detyruese te dispozitave te tjera.

32. NDRYSHIMET NE RIO DHE MI

- 32.1 Ndryshimet ose shtesat e kesaj ORI, duke perfshire Anekset e saj, Amendamentet, Shtojcat dhe Listat e Sherbimeve, behen sipas percaktimeve ligjore dhe nenligjore dhe jane objekt i miratimit nga AKEP. Ndryshimi i tarifave qe nuk jane objekt rregullimi nga AKEP, hyjne ne fuqi pa miratimin e AKEP, per sa kohe AKEP nuk shprehet me vendim per mosmiratimin/pezullimin e ndryshimit te tyre.

32.2 Cdo amendim i ORI se TELEKOM ALBANIA (pervec rasteve ne piken 32.3) qe kryhet ne perputhje me udhezimet/vendimet e AKEP e ka lidhje me percaktimin, rregullimin ose heqjen nga rregullimi te tarifave apo sherbimeve te perfshira ne ORI-n e TELEKOM ALBANIA behet pjese e marrveshjes se interkoneksionit te lidhura nga TELEKOM ALBANIA me palet e tjera, me efekte nga data e percaktuar nga AKEP per hyrjen ne fuqi te tyre.

32.3 Cdo amendim i kesaj ORI per

- perfshirjen e sherbimeve te reja nga TELEKOM ALBANIA ne ORI,
- ndryshimin e tarifave qe nuk jane nen-rregullim nga AKEP

do te duhet te materializohet me nenskrimin nga te dy palet te nje amendimi te marrveshjes se interkoneksionit.

33. MARREDHENIA MES PALEVE

- 33.1 Marredhenia e interkoneksionit mes paleve do te jete ajo mes dy sipermarresve te pavarur nga njeri tjetri. Asgje ne kete ORI, qe do te sherbeje per lidhjen e Marrevshjes se Interkoneksionit, nuk do te konsiderohet se krijon nje marredhenie agjensie, joint venture, apo partneriteti mes paleve. Asnjeres prej paleve nuk i jepet ndonje e drejte autorizimi apo agjensie, ne menyre te shprehur apo te nenkuptuar, qe per llogari apo emer te pales tjeter, te detyroje ligjerisht palen e pare ne cfare do lloj menyre. Asnje nga palet nuk do te jete ligjerisht pergjegjese per shkak te ndonje prezantimi, akti apo veprimi te pales tjeter, i cili bie ne kundertshti apo nuk ligjerohet nga dispozitat e marrevshjes se interkoneksionit, bazuar ne kete ORI.

34. LIGJI I ZBATUESHEM DHE GJYKATA KOMPETENTE

- 34.1 Interpretimi, vlefshmeria dhe zbatimi i kesaj ORI dhe marrevshjes se interkoneksionit bazuar ne te, do te udhehiqet ne te gjitha aspektet nga ligjet e Republikes se Shqiperise dhe organi gjyqesor kompetent per zgjidhjen e mosmarrevshjeve eshte ajo e percaktuar ne dispozitat perkatese te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise..